

## **ANALIZA E REZULTATEVE TË MATURES SHTETËRORE 2022-2023**

Për të pasur më shumë informacion mbi ecurinë e maturës shtetërore dhe për të nxjerrë konkluzione sa më të sakta, po përshkruajmë punën që është bërë si dhe rezultatet e arritura nga maurantët e 2022-2023.

Në fillim të vitit shkollor drejtoria e shkollës planifikoi dhe ndërtoi punën për ecurinë e procesit të MATURES SHTETËRORE, për të cilën ndërtoi një plan të detajuar i cili përmban:

1. Planifikimin e orëve të konsultimeve në lëndët e letërsisë e gjuhës shqipe, matematike, anglisht e teori profesionale në orarin vjetor të shkollës.
2. Shtesë me një ore mesimore në lëndën e matematikës, sepse nxënësit e shkollës tonë paraqesin shumë dobësi.
3. Mësuesit e lëndëve letërsi-gjuhë shqipe, anglisht, matematike dhe teori profesionale hartojnë programin e detajuar të konsultimeve.
4. Ndërtohet këndi i maturës shtetërore.
5. Afishimi i çdo informacioni që ka lidhje me Maturën Shtetërore.
6. Punohet dispozitat e përgjithshme dhe rregullorja e Maturës Shtetërore.
7. Krijimi i komisionit shkollor të maturës shtetërore.
8. Përcaktohen detyrat e komisionit mbështetur në rregulloren për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore.
9. Nxënësit janë informuar për plotësimin e formulareve A1, A2 si dhe A1Z.
10. Ngarkohet mbikqyresi me ndjekjen e procesit të maturës si dhe përfundimin me sukses të Maturës 2022,
11. Njoftohen maurantët e viteve të kaluara, të cilët duan të aplikojnë dhe të plotësojnë formularin, për datat dhe dokumentacionin si dhe mënyrën e plotësimit të formularit A1Z.
12. Maurantët janë njohur me ID si dhe tabelën me informacionet personale perkatese.
13. Afishohet në këndin e Maturës Shtetërore rregullorja e provimeve të MSH .
14. Drejtoria e shkollës evidentoi kalueshmërinë e nxënësve maurantë një ditë pas përfundimit të vitit shkollor.
15. Gjate procesit të keshillimit të maurantëve i është vënë rëndësi mënyrës së qëndrimit në provimet e maturës, mjetet që duhet të kenë me vete, si dhe sanksionet në rast shkelje rregullash si dhe përdorimi i celularit gjatë provimit.
16. Çdo mësues kujdestar, kujdeset që nxënësit të jenë të pajisur me dokumente identifikues.
17. Nxënësve ju është dhënë informacion rreth edukimit për karriere nëpërmjet bisedave të vazhdueshme me mësuesit kujdestar .
18. Janë bërë takime me pedagog rreth fakulteteve dhe kushteve që ofrojnë.
19. Nxënësit përpara se të plotësojnë A2 njihen me deget, piket si dhe mesataren për çdo degë.

## **ANALIZA E REZULTATEVE TË MATURËS SHITETERORE 2022-2023**

Me poshtë po bëjmë një analizë të rezultateve të arritura në MSH 2023.

Tabela tregon % e kalueshmërisë në D1,D2,D3,Z1 si dhe notën mesatare.